

**REZOLUTË**  
**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE PËR**  
**VITIN 2019**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur misionin e INSTAT-it për prodhimin e statistikave asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit;

Duke marrë në konsideratë se INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend dhe përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;

Duke vlerësuar se statistikave zyrtare shpërndahen duke respektuar parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke siguruar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave zyrtare brenda dhe jashtë vendit, për të plotësuar nevojat e tyre me informacion cilësor e të përditësuar dhe për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera në rajon dhe Evropë;

**Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Statistikave gjatë vitit 2019 në drejtim të:**

- Realizimit të të gjitha aktiviteteve të parashikuara sipas dokumentit strategjik dhe buxhetit të Censit dhe sidomos aktivitetit më të rëndësishëm të fazës përgatitore, Pilotit të Censit.

- Kontributit me dy aktivitete statistikore *ad-hoc* për të matur impaktin e dëmeve të tërmetit pranë familjeve dhe ndërmarrjeve në zonat më të prekura.

- Shtimit të prezencës në media lidhur me transmetimin e të dhënave të prodhuara dhe kuptueshmërinë e produkteve statistikore.

- Prodhimit të statistikave zyrtare në nivel vendor, për një njohje dhe kuptim më të mirë të të dhënave në secilën bashki e komunë të vendit.

- Rritjes së bashkëpunimit me botën akademike përmes shkëmbimit të praktikave, bashkëpunimit për përgatitjen e artikujve shkencorë dhe sigurimit të aksesit në të dhënat mikro për qëllime shkencore.

- Ngritjes së grupit ndërinstitucional të punës për integrimin evropian dhe angazhimit për furnizimin me informacionin e duhur statistikor të të gjithë kapitujve të tjerë të *acquis*.

**Kuvendi rekomandon që Instituti i Statistikave për vitin 2020 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

- Të ketë transparencë të plotë të kontributit që jep Këshilli i Statistikave në INSTAT, në përmbushje të detyrimeve që i ngarkon ligji nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare”. Të publikohen raportet e rekomandimeve të lëna nga Këshilli i Statistikave dhe aktet e miratuara nga bordi drejtues, duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale. Të publikohet pjesëmarrja e anëtarëve në çdo mbledhje dhe mënyra sesi ka votuar secili anëtar.

- Të plotësojë sa më parë vendet vakante në pozicionet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues, për të garantuar menaxhimin e nëpunësve civilë sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

- Të marrë masa konkrete për të reduktuar riskun e veprimtarisë statistikore, që mund të shkaktohet nga rastet e fatkeqësive natyrore, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e proceseve. Masat e marra të paraqiten në planin vjetor të INSTAT-it.

- Të fuqizojë kapacitetet e teknologjisë së informacionit, si në infrastrukturë, ashtu edhe në staf të kualifikuar për përpunim modern të dhënash dhe prodhim statistikash cilësore.

- Të vazhdojë punën për përmirësimin e pyetësorit të Censit, si edhe materialeve të tjera shoqëruese, bazuar në gjetjet e Pilot Censit të kryer në vitin 2019, si dhe të përditësojë zonat në terren pas situatave të krijuara nga emergjencat e fundit që kanë ndodhur në vend.

- Të hartojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Censin e Bujqësisë 2022.

- Të harmonizojë Strategjinë e Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor me formatin e strategjive të tjera kombëtare dhe sektoriale për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar, IPSIS, përfshirë edhe hartimin e planit strategjik për përafrimin me *acquis* në fushën e statistikave, duke marrë në konsideratë edhe prioritetet e vendosura nga BE-ja në procesin e çeljes së negociatave me Shqipërinë.

- Të finalizojë ngritjen e Komitetit të Prodhuesve të Statistikave Zyrtare, i cili është një mekanizëm i rëndësishëm për cilësinë e proceseve të planifikimit dhe ndjekjes së aktiviteteve statistikore.

- Të punojë për t'iu përafruar gjithnjë e më tepër pritshmërive dhe kënaqësisë së përdoruesve të statistikave zyrtare, duke respektuar në mënyrë rigorozë parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare, nëpërmjet rritjes së edukimit statistikor dhe organizimit të takimeve formale e informale me përfaqësuesit e medias.

**KRYETAR  
Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 23.7.2020